

# **PËRMIRËSIMI I ROLIT TË KUVENDIT NË LIGJBËRJEN DHE MBIKQYRJEN E ÇËSHTJES SË RIKUPERIMIT TË ASETETEVE**

**(DOKUMENT PUNE)**

**Dhjetor, 2023**

Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

**Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.**

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

## **Tabela e përmbajtjes**

Përmbledhje ekzekutive .....	4
I. Metodologjia .....	6
II. Qasje teorike mbi rolin ligjbërës dhe mbikëqyrës të Kuvendit.....	7
III. Rikuperimi i aseteve në Shqipëri .....	9
IV. Roli mbikëqyrës i kuvendit në çështjet e rikuperimit të aseteve.....	21
4.1 Roli mbikëqyrës i kuvendit.....	21
4.2 Roli i aktorëve të sistemit parlamentar në mbikëqyrjen efektive të fushës së rikuperimit të aseteve .....	21
4.3 Roli i aktorëve të sistemit jo-parlamentar në mbikëqyrjen efektive të rikuperimit të aseteve	22
V. Rekomandime .....	23
Referencat .....	25
Aneks 1: Lista e pyetjeve në fushën e prokurimeve publike.....	27
Aneks 2: Listë e konsultimeve në proces mbi aspekte specifike të rikuperimit të aseteve kriminale në Shqipëri .....	29
Aneks 3: Lista e akteve ligjore.....	30

## Përmbledhje ekzekutive

Në Shqipëri, rikuperimi i aseteve është një sfidë e madhe e cila kërkon vëmendjen e të gjitha institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në mënyrë direkte dhe indirekte. Kuvendi si institucioni kryesor legjislativ në Shqipëri ka një rol të rëndësishëm në mbikqyrjen e procesit të rikuperimit të aseteve.

Ky dokument pune analizon rolin e Kuvendit si ligjbërës dhe mbikëqyrës në procesin e rikuperimit të aseteve në Shqipëri dhe disa përmirësime në funksionimin e tij. Për të bërë një vlerësim të tillë, fillimisht dokumenti përshkruan të gjithë kornizën ligjore e cila mbulon rikuperimin e aseteve në Shqipëri. Më pas, është shqyrtuar me detaje një projektligj i veçantë i propozuar nga një deputet i Kuvendit “Për përgjegjësinë financiare të punonjësve publikë”. Ky vlerësim për identifikimin e hapësirave korruptive, është realizuar duke konsideruar një listë kriteresh të trajtuara gjerësisht në kapitullin përkatës.

Në këtë dokument pune, është marrë në shqyrtim inisiativa legjislative e deputetit B. L., projektligji<sup>1</sup> “Për përgjegjësinë financiare të punonjësve publikë”. Ky projektligj nuk ndryshon ligjin në fuqi nr. 34/ 2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”. Në fakt, ai synon synon të rikuperojë në mënyrë të shpejtë, shpërblimin (pasuri e luajtshme- vlerë monetare) për dëme të pretenduara të punonjësve publikë dhe t'i rikthejë ato në buxhetin e Shtetit. Vlerësimi i këtij projektligji është bërë duke konsideruar kriteret e ekzaminimit të hapësirave korruptive të trajtuara gjerësisht në kapitullin kryesor të këtij dokumenti. Sa më poshte gjatjet kryesore dhe rekomandimet përkatëse.

## A. DYKUPTUESHMËRIA

- Projektligji ka formulime të paqarta dhe që hapësirë për dykuptimësi. Më konkretisht, në nenin 2 parashikohet se: “Ligji ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet që lindin midis subjekteve dhe punonjësve publikë dhe të vendosë procedura lidhur me dëmet e shkaktuara prej këtyre të fundit, në periudhën që ata janë ose kanë qenë të punësuar ose në çfarëdo marrëdhënie me subjektin publik.” Shprehja “në çfarëdo marrëdhënie me subjektin publik” lë hapësirë për dykuptimësi. Kjo duhet saktësuar. Kështu, sugjerohet që Shprehja “...në çfarëdo marrëdhënie me subjektin publik” të hiqet.
- Në projektligji, në nenin 35, fjalia e dytë parashikohet se: “Çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet”. Ky lloj parashikimi është i papranueshëm për teknikën legjislative se jo vetëm vë në rrezik qenien ose jo në fuqi të dispozitave të tjera, por lë vend për keqkuptime dhe keqzbatim, kështu sugjerohet të hiqet. Në projektligj duhet të parashikohen saktë vetëm dispozitat ligjore konkrete që shfuqizohen dhe jo të përdoret një shprehje e tillë e karakterit të përgjithshëm që krijon paqartësi.
- Terminologjia e përdorur në këtë projektligj është jashtë terminologjisë ligjore të konsoliduar me Kodet, që janë në fuqi. Më konkretisht, në nenin 8, të projektligjit përdoret termi “Përgjegjësia e përbashkët”, ndërkohë për atë koncept juridik në kreun II

---

<sup>1</sup>Faqe zyrtare e Kuvendot. Marrë nga <http://staging.parlament.al/ProjektLigje/IndexList>.

“Detyrimet solidarë”, (nenet 423- 435) të Kodit Civil jepet në mënyrë shterruese se kur jemi para një detyrimi solidar, pra nuk përdoret termi “I përbashkët”, por solidar.

## **B. RREZIQET SUBSTANCIALE**

- Në relacionin shoqërues të projektligjit nuk ka asnjë vlerësim paraprak të gjendjes faktike, e cila synohet të ndryshohet me këtë projektligj. Pra thuhet se ka një hendek mes dëmeve të pretenduara dhe rikuperimit të tyre, por pa e shoqëruar me asnjë statistikë. Dëme të pretenduara nga cili autoritet shtetëror, a janë ndjekur procedurat ligjore përkatëse, cilat janë vendimet gjyqësore në përfundim të atyre gjykimeve. Pa një përshkrim të saktë të situatës faktike nuk mund të dilet as në konkluzione dhe as të ofrohet zgjidhja e duhur, për më tepër një projektligj si ky që ndryshon jo vetëm ligjet në fuqi, por edhe doktrinën e së drejtës, duke krijuar një përgjegjësi të re, jashtë përgjegjësisë disiplinore, administrative apo penale (neni 3, i projektligjit). Arsyetimi i dhënë tek relacioni shoqërues është i pamjaftueshëm, pasi në të thuhet se pengesë ndër të tjera është neni 117 i Kodit të Punës dhe vendim nr. 1354, datë 6. 10. 2005, i Gjykatës së Lartë që nuk e njeh përgjegjësinë materiale. Në këtë kuptim, relacioni nuk përmban arsyetimin e duhur ligjor dhe argumentet në lidhje me pyetjet që lindin mbi këtë projektligj.
- Procedurat për vendimarrje janë të parashikuara në nenet 18- 27 të projektligjit, por mungon afati ligjor brenda të cilit titullari i institucionit nga ardhja në dijeni e një raporti për dëm eventual fillon procedurën për seancë dëgjimore. Mos parashikimi i një afati të tillë ligjor lë një hapësirë për rrezik korrupsioni, që ndaj dikujt fillohet procedura dhe ndaj dikujt jo.
- Në projektligj nuk parashikohet një mekanizëm i posaçëm mbikqyrës, por ka një mundësi ligjore për secilin subjekt që të ushtrojë ankim në gjykatë, kur konstaton se ligji është shkelur apo nuk është zbatuar si duhet.
- Projektligji nuk garanton transparencë në zbatimin e tij, pasi nuk ka të parashikuar ndonjë dispozitë në të, që të paktën një herë në vit institucionet e ngarkuara të publikojnë një raport të përmbledhur, me të dhëna personale të anonimizuara, për çështjet që kanë shqyrtuar, vendimarrjet e tyre dhe të përditësohet me vendimet respektive të Gjykatave.

## **I. Metodologjia**

### **1.1 Analiza e studimeve ekzistuese**

ACER ka realizuar një grumbullim shterues të të gjithë studimeve mbi fushën e rolit mbikëqyrës të Kuvendit si dhe fushës së rikuperimit të aseteve. Këtu janë përfshirë raportet e ndryshme të organizatave ndërkombëtare, të të tretëve, institucioneve me reputacion ndërkombëtar, etj, si: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Bashkimi Evropian (BE), Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimi (UNODC), Këshilli i Evropës, në lidhje me procedurat e prokurimit në Shqipëri; Raportet vjetore (të brendshme) të KLGJ-së, Gjykatave dhe të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara (AAPSK) mbi pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara si dhe statistikat e çështjeve të hetuara, të gjykuara; raportet e organizatave të shoqërisë civile të cilët kanë trajtuar qasjen institucionale dhe ligjore të rikuperimit të aseteve. Përveç studimeve që lidhen direkt me çështjen e rikuperimit të aseteve, ACER ka shqyrtuar

### **1.2 Analizë e legjislacionit primar dhe sekondar mbi fushën e rikuperimit të aseteve në Shqipëri**

Shkurtimisht, ACER ka zhvilluar një analizë ligjore të legjislacionit në fuqi mbi fushën e rikuperimit të aseteve, për të informuar aktorët (edhe qytetarët) mbi rëndësinë e këtij legjislacioni dhe ndikimin e tij në disa drejtime.

### **1.3 Tryezë e rrumbullakët**

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike, në datën 11 Korrik, 2023, organizoi një tryezë të rrumbullakët për të prezantuar gjetjet paraprake të dokumentit të punës, si dhe për të diskutuar mbi aspekte të tjera problematike në fushën e rikuperimit të aseteve në vend, duke shoqëruar edhe me rekomandimet përkatëse për trajtimin e tyre. Në këtë tryezë të rrumbullakët morën pjesë 39 individë që përfaqësonin Kuvendin e Shqipërisë, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, ekspertë të pavarur, si dhe përfaqësues nga Ambasada Britanike në Shqipëri. Gjatë kësaj tryeze, ekipi i ACER prezantoi gjetjet e punës dhe u fokusua në diskutimin e këtyre gjetjeve. Pjesëmarrësit diskutuan mbi nevojën për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Kuvendit në monitorimin e procesit të rikuperimit të aseteve të padrejta në vend, duke theksuar përfshirjen e ekspertizës së pavarur për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërmarra.

Gjithashtu, i shënua nevoja për të rritur transparencën në procesin e rikuperimit të aseteve të padrejta, duke përfshirë nevojën për raportim të rregullt dhe transparent në Kuvend rreth progresit të arritur në këtë fushë, si dhe nevojën për publikimin e të dhënave lidhur me rastet e rikuperimit të aseteve. Diskutimet shënuan dhe rolin tejet të rëndësishëm që aktorët e shoqërisë civile duhet të luajnë mbi përmirësimin e transparencës mbi këtë fushë dhe rritjen e bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë për të përmirësuar aspektet legjislative mbi këtë fushë.

## II. Qasje teorike mbi rolin ligjbërës dhe mbikëqyrës të Kuvendit

Për të analizuar rolin e Kuvendit në Republikën e Shqipërisë duhet t'i referohemi Kushtetutës<sup>2</sup>, në të cilën parashikohet, në nenin 1, pika 1, të saj: “*Shqipëria është republikë parlamentare*”. Në nenin 2, pika 2, të Kushtetutës se: “*Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsërdrejtë*”, si dhe në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se: “*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.*” Këto parashikime kushtetuese e kornizojnë llojin e sistemit parlamentar që ne kemi e për rrjedhojë edhe rolin e Kuvendit si ushtrues i pushtetit legjislativ në vend.

Kuvendi ushtron **pushtetin legjislativ** e kjo kompetencë substanciale e tij rrjedh nga neni 81 e vijues i Kushtetutës. Edhe nga neni 116 i Kushtetutës, ku përcaktohet hierarkia e burimeve të së drejtës dhe rezulton se aktet e miratuara nga Kuvendi, si: (i) Kushtetuta, (ii) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, (iii) ligjet, janë të epërme ndaj akteve të tjera, madje vullneti i Kuvendit, nëpërmjet ligjeve përkatëse është përcaktues edhe për atë “pushtet” të vogël normues, që iu është lënë organeve të pushtetit ekzekutiv. Në nenin 118 të Kushtetutës përcaktohet se: “*1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte...*”

Kuvendi zgjedh Presidentin e Republikës, miraton emërimin e Kryeministrit, programin politik të Këshillit të Ministrave bashkë me përbërjen e tij, si dhe emëron edhe funksionarë të tjerë që përcaktohen shprehimisht në Kushtetutë apo në ligje të posaçme.

Në nenin 80, të Kushtetutës parashikohet ndër të tjera se: “*1. Kryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar t’iu përgjigjet interpelancave dhe pyetjeve të deputetëve brenda tri javëve*”...3. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për sa e lejon ligji.” Pra konstatohet **roli kontrollues i Kuvendit mbi pushtetin ekzekutiv**.

Kuvendi mund të ushtrojë rolin e tij mbikëqyrës në disa forma të ndryshme, përfshirë:

- **Pyetjet, interpelancat dhe mocionet<sup>3</sup>**

Të gjithë deputetët kanë të drejtën të paraqesin pyetje Kryeministrit ose çdo anëtar tjetër të Këshillit të Ministrave. Pyetjet paraqiten nga deputetët të Kryetari i Kuvendit, i cili informon anëtarin e Këshillit të Ministrave, të cilët i drejtohen pyetjet. Pyetjet bëhen me qëllim për të marrë informacion lidhur me një ose disa çështje të caktuara. Pyetjet duhet të jenë të shkruara në një mënyrë të qartë dhe të përmbledhur dhe të përmbajnë çështje

<sup>2</sup> E miratuar me ligjin nr. 8417, datw 21. 10. 1998, i ndryshuar;

<sup>3</sup> Pjesa e tretë, kontrolli i kuvendit kreu i, pyetjet, interpelancat dhe mocionet. Rregullorja e kuvendit.

që ndodhen brenda kompetencave të personave që pyetjet drejtohen, ose në lidhje me veprimtarinë administrative për të cilën po kërkojnë përgjigje.

- **Kontrolli nga komisionet e përhershme të Kuvendit<sup>4</sup>**

Komisionet e përhershme të Kuvendit mund të paraqesin raporte ose propozime për çështje nën kompetencën e tyre ose kur iu kërkohet nga Kuvendi. Ata gjithashtu kanë të drejtë të kryejnë kontrole dhe të kërkojnë dokumentacion për të analizuar një çështje të veçantë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë.

**Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut** shqyrton brenda fushave të përgjegjësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryen studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjek zbatimin e ligjeve dhe kontrollon veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozon për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta. Fushat e përgjegjësisë: Kodet dhe organizimi i pushtetit gjyqësor, administrata publike, administrata e pushtetit gjyqësor, organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor, shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut si dhe çështjet e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimi i angazhimeve që rrjedhin prej saj.

**Komisioni për Ekonominë dhe Financat** shqyrton brenda fushave të përgjegjësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryen studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjek zbatimin e ligjeve dhe kontrollon veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozon për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta. Fushat e përgjegjësisë: Politikat ekonomike, Buxheti i Shtetit dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij, financat publike, privatizimet dhe sistemi bankar si dhe çështjet e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimi i angazhimeve që rrjedhin prej saj.

- **Raportimi në Kuvend<sup>5</sup>**

Kryetari i Kuvendit, nëpërmjet Konferencës së Kryetarëve, vendos në fillim të çdo viti për kalendarin e paraqitjes së raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj në Kuvend. Ky kalendar përfshin organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj që do të paraqesin raportet, si dhe komisionin përgjegjës për shqyrtimin e tyre dhe afatin ligjor për depozitimin në Kuvend. Kuvendi i kërkon zyrtarisht institucioneve të përcaktuara dorëzimin e raporteve brenda afatit ligjor në Kuvend. Kalendari i paraqitjes së raporteve bëhet i njohur në seancën plenare të parë, publikohet dhe shpërndahet institucioneve përkatëse.

---

<sup>4</sup> Neni 102, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

<sup>5</sup> Neni 100, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

### III. Rikuperimi i aseteve në Shqipëri

Raporti i Indeksit Global të Krimin të Organizuar për vitin 2021 tregon se katër nga gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia) janë pjesë e dhjetë vendeve me nivelet më të larta në Evropë për krime të organizuara.<sup>6</sup> Këto vende kanë një shtrirje, shkallë dhe ndikim të lartë të tregjeve të paligjshme, që është mbi mesataren globale. Kjo sugjeron se në këto vende ka një numër të lartë kriminelësh që qarkullojnë nivele të larta të mjeteve monetare të jashtëligjshme. Megjithatë, një sasi shumë e vogël asetesh kriminale sekuestrohen. Ky problem mund të jetë tregues në aspektin e qëndrueshmërisë, duke treguar se këto vende kanë sisteme të dobëta ose të komprometuara të drejtësisë, transparencës dhe llogaridhënies jocilësore të qeverisë. Kështu, 92% e qytetarëve në këto vende perceptojnë krime të organizuara, të rënda dhe financiare si sfidën më urgjente të sigurisë që duhet të adresohet në rajon.<sup>7</sup>

#### 3.1 Analizë e legjislacionit primar dhe sekondar mbi fushën e rikuperimit të aseteve në Shqipëri

Bazuar te hierarkia e burimeve të së drejtës në vend të parë në fushën e rikuperimit të aseteve janë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në këtë fushë, e konkretisht:

*Ligji nr. 8635 datë 06. 07. 2000 "Për ratifikimin e Konventës Civile për korrupsionin";*

Neni 2

Përcaktimi i korrupsionit

Për qëllimet e kësaj Konvente, fjala "korrupsion" merr kuptimin e të kërkuarit, ofrimit, dhënies ose pranimit drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë të një mitëmarrje ose çdo lloj tjetër avantazhi ose përfitimi që deformon kryerjen e çdo detyre ose sjellje të kërkuar nga pranuesi i mitëmarrjes, për pasojë dhe të avantazhit e përfitimit të padrejtë.

Neni 3

Kompensimi i dëmtimit

1. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar, për personat që janë dëmtuar si rezultat i korrupsionit, të drejtën për të inicuar një veprim në mënyrë që të marrin kompensim të plotë për një dëmtim të tillë.
2. Një kompensim i tillë mund të mbulojë dëmtimin material, humbjen e përfitimeve dhe humbje jomonetare.

Neni 8

Vlefshmëria e kontratave

1. **Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar që çdo kontratë ose pjesë kontrate për korrupsion të anulohet dhe të jetë e pavlefshme.**
2. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar mundësinë që të gjitha palët në kontratë, leja e të cilëve është shpërdoruar nga një veprim korruptiv, të kenë mundësinë

<sup>6</sup> Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore. (2021). "Buletini i Rreziqeve 10, Tetor-Nëntor 2021." Indeksi Global i Krimin të Organizuar. Marrë nga <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/11/GITOC-SEEOBS-RB-10.pdf>.

<sup>7</sup> SecuriMeter, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal. (2021). Marrë nga [https://www.rcc.int/download/docs/WB\\_SecuriMeter\\_Infographics\\_Feedback\\_previewIZMJENJENO-lowres.pdf/98da5bf3cdaed5b03d59ce79c6ced2de.pdf](https://www.rcc.int/download/docs/WB_SecuriMeter_Infographics_Feedback_previewIZMJENJENO-lowres.pdf/98da5bf3cdaed5b03d59ce79c6ced2de.pdf).

e apelimit në gjykatë për ta shpallur të pavlefshme dhe në kundërshtim me të drejtën e tyre për t'u ankuar për dëmtimet.

*Ligji nr. 8778, datë 26. 04. 2001 "Për ratifikimin e "Konventës Penale për korrupsionin";*

Neni 13

Pastrimi i parave të produkteve nga veprat e korrupsionit

Secila Pale do të miratojë masa të tilla legjislative, dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në Konventën e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit (Seria e traktateve evropiane nr.141) neni 6 paragrafët 1 dhe 2, sipas kushteve të referuara aty, kur vepra e treguar konsiston në një nga veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 12 të kësaj konvente, në rastin kur Pala nuk ka bërë rezervime apo deklarime, lidhur me këto vepra ose nuk i konsideron këto vepra si serioze për qëllimin e legjislacionit të saj për pastrimin e parave.

*Ligji nr. 9492, datë 13. 3. 2006 "Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit"*

Neni 51

Dispozitë e përgjithshme

Kthimi i aseteve sipas këtij kapitulli është një princip themelor i kësaj Konvente dhe shtetet palë i lejojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit dhe asistencës në këtë fushë.

Neni 57

Kthimi dhe hedhja e aseteve

1. Prona e konfiskuar nga një shtet palë sipas nenit 1 ose 55 të kësaj Konvente do të hidhet, duke përfshirë me kthim të pronarëve të mëparshëm legjitimë, sipas paragrafit 3 të këtij neni, nga ai shtet palë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe së drejtës së brendshme.

2. Secili shtet palë do të adaptojë masa të tilla legjislative dhe të tjera në përputhje me parimet themelore të së drejtës së saj të brendshme, siç mund të jetë e nevojshme për të bërë të mundur organet e veta kompetente të kthejnë pronën e konfiskuar, kur veprojnë me kërkesën e bërë nga një tjetër shtet palë, në përputhje me këtë Konventë, duke marrë në konsideratë të drejtat e palëve të treta bona fide...."

Këto Konventa marrë në kompleksitet janë baza për legjislacionin e brendshëm në fushën kundër korrupsionit, parashikimeve civile dhe penale, në fushën e pastrimit të parave dhe të rikuperimit të aseteve, të krijuara nga këto veprimtari të paligjshme.

Përveç pjesës ligjore, ka një serë kodesh dhe ligjesh të tjera, nga rrjedhin pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara:

- *Kodi<sup>8</sup> Penal*: Në Kodin Penal, një nga dënimet plotësuese parashikohet edhe “konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale” (neni 30, pika 2, e Kodit Penal). Me një dispozitë të posaçme parashikohen se cilat janë këto mjete të kryerjes së veprës penale dhe produkte të asaj vepre, të cilat detyrimisht konfiskohen me vendim të Gjykatës. (neni 36, i Kodit Penal)
- *Kodi<sup>9</sup> i Procedurës Penale*: Në kreun VI të Kodit të Procedurës Penale parashikohen masat e sigurimit pasuror të cilat ndahen në sekuestro konservative, si garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve procedurale apo të cdo detyrimi ndaj shtetit (neni 270, i K. Pr. Penale) dhe në sekuestro preventive për produktet e veprës penale. (neni 274, i K. Pr. Penale)
- *Ligji nr. 10 192, datë 3.12. 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*: Edhe nga objekti i këtij ligji rezulton se në të përcaktohen procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e *masave parandaluese kundër pasurisë së personave*, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar në krimin e organizuar, trafikim dhe korrupsion. Me masë parandaluese në kuptimin e këtij ligji është çdo masë me karakter pasuror, që gjykata vendos në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre. Në këtë ligj del si subjekt për të ofruar listat e administratorëve dhe të specialistëve të tjerë, për të administruar pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pozita juridike e së cilës rregullohet me ligj të posaçëm, si më poshtë shpjeguar. Në kuadër të këtij ligji është Ministri i Financave, i cili përcakton mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara, bazuar në rekomandimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat kundër Krimit të Organizuar dhe në raportin e vlerësimit tekniko-financiar të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Ministri i Financave me përfundimin e vitit financiar i paraqet Këshillit të Ministrave raportin për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara sipas këtij ligji.

*Ndëkohë, ligji kryesor mbi rikuperimin e asetëve në vend është Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar*. Është ligji bazë në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Ky ligj përcakton rregullat, procedurat dhe strukturën administrative për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e drejtësisë, administrimin e pasurive të sekuestruara nga organet administrative dhe ruajtjen e provave materiale, sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi. Institucionet vendimmarrëse sipas këtij ligji janë: Komiteti Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, Agjencia, administratorët. Në kuadër të këtij ligji është

<sup>8</sup> I miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27. 1. 1995, i ndryshuar;

<sup>9</sup> I miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21. 3. 1995, i ndryshuar;

ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që paraqet në muajin janar të çdo viti, raport para Këshillit të Ministrave dhe komisionit përgjegjës për çështjet ligjore të Kuvendit.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është krijuar në zbatim të ligjit nr. 9284, date 30. 09. 2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe aktualisht funksionon në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3. 12. 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara ka për objekt kryesor të veprimtarisë administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës, administrimin e pasurive të bllokuara, sekuestruara, dhe administrimin e pasurive të tjera, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to dhe administrimin e provave materiale të konfiskuara dhe shitjen e tyre. AAPSK drejtohet nga kryeadministratori dhe ka në përbërje 14 punonjës. Punonjësit e AAPSK janë nëpunës të shërbimit civil. Në përbërje të AAPSK janë edhe administratorët e ndihmës administratorët e pasurive, numri i të cilëve përcaktohet nga pasuritë e marra në administrim, llojet dhe volumi i punës për administrimin e këtyre pasurive.

Në kontekstin shqiptar, nga legjislacioni i analizuar rezulton se cilat pasuri mund të sekuestrohen dhe konfiskohen, bazuar në cilin ligj të posacëm dhe për cilat figura veprash penale. Një arritje më vete është krijimi i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për t'i administruar këto pasuri, edhe pse sfidat që shtrihen sërish janë disaplanshë: (i) A kompensohen gjithmonë viktimat e krimit me këto pasuri, apo shpesh viktimat e këtyre krimeve nuk kanë zë në proceset penale dhe nuk arrijnë të dëmshpërblehen në përfundim të tyre? (ii) A ka transparencë në administrimin e këtyre pasurive deri në disponimin e tyre? (iii) A ka patur raste që këto pasuri kanë përfunduar sërish në duart e përfaqësuesve të krimit?

### **3.2 Gjetje nga studimi cilësor**

Për të bërë një analizë të situatës, që lidhet me problematikat e fushës së rikuperimit të aseteve në Shqipëri, ACER ka realizuar disa intervista të thelluara më aktorët e mëposhtëm:

- Deputetët në kuvend;
- Kontrolli i Lartë i Shtetit;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
- Avokati i popullit;
- CSOs;
- Përfaqësues të medias;
- Përfaqësues të biznesit.

Disa nga bizneset dhe shoqatat e tyre të kontaktuar gjatë këtij procesi, treguan se megjithëse ato kanë aktivitet të rëndësishëm ekonomik në Shqipëri, për shkak të ndjeshmërisë ndaj fushës së rikuperimit të aseteve, përgjithsisht bizneset nuk preferojnë të marrin në përdorim asete të tilla për aktivitetet e tyre prodhuese.

Përfaqësues të mediave treguan se kanë qenë aktivë në pasqyrimin e problematikës së rikuperimit të aseteve në Shqipëri<sup>10</sup> dhe se kanë kontribuar në ndërtimin e një databaze publike të aseteve kriminale në vend<sup>11</sup>, e cila tregon me transparencë të plotë detajet e këtyre aseteve dhe lidhjet e tyre me vendimet përkatëse ligjore. Sipas tyre, problemi me sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të krimit duket se lidhet me mungesën e kulturës së përgjithshme të shtetit ligjor dhe jo me ndonjë defekt në legjislacion. Në përgjithësi vërehet se sekuestrimi paraprak i aseteve të krimit është joefektiv pasi administratorët shtetërorë dështojnë të kryejnë në praktikë funksionin bazë të sekuestrimit, mohimit të personave të dyshuar të përdorin pasurinë si burim pushteti ndërsa në disa raste, nëse vërehet se pronat e sekuestruara gjenden në zona me prani të theksuar të grupimeve kriminale, ku kontrolli i Policisë së Shtetit mbi territorin është i mangët, është e paarsyeshme të presësh ushtrim efikas të funksionit të administrimit nga ana e administratorëve shtetërorë. Raste të ndryshme sekuestrimi sugjerojnë se personat e dyshuar apo familjarë të tyre vijojnë të kenë kontroll të plotë të kompanive. Kompanitë e sekuestruara duken pothuajse njësoj të suksesshme në aksesimin e fondeve publike edhe pas sekuestrimit, si kontraktorë apo si nënkontraktorë.

Përfaqësues të shoqërisë civile treguan se nuk marrin pjesë në procedura ankandi për të blerë pasuri që janë të konfiskuara nga Shteti. Por, nëpërmjet dy projekteve që janë ndjekur (njëri i përfunduar dhe tjetri në zbatim) me mbështetjen financiare të BE, nëpërmjet një marrëveshje bashkëpunimi me AAPSK u janë vendosur në dispozicion pasuri të konfiskuara, të cilat më pas janë ripërdorur për qëllime sociale (social re-use) nga OJFtë. Nëpërmjet projektit CAUSE, janë krijuar tre sipërmarrje sociale të menaxhuara nga OJFtë në tre asete të konfiskuara, nëpërmjet një kontrate 5 vjecare që OJFtë kanë lidhur me AAPSK për ripërdorim social (pa pagesë), ndërkohë që është duke u mbyllur procesi për ripërdorimin social edhe të një pasurie tjetër nëpërmjet projektit TWIST, si dhe do të mbështesin financiarisht një sipërmarrje që aktualisht është ngritur në një aset të konfiskuar<sup>12</sup>.

---

<sup>10</sup> Reporter. (2021, tetor 1). "Saga gjyqësore e kompleksit Golden mbyllet me pushim." Marrë nga

<https://www.reporter.al/2021/10/01/saga-gjyqesore-e-kompleksit-golden-mbyllet-me-pushim/>;

Reporter. (2022, korrik 28). "Sekuestrohen pronat e biznesmenit të dënuar për trafik droge, Anton Gjinaj." Marrë nga <https://www.reporter.al/2022/07/28/sekuestrohen-pronat-e-biznesmenit-te-denuar-per-trafik-droge-anton-gjinaj/>.

<sup>11</sup> <http://asete.reporter.al/>

<sup>12</sup> Partners Albania. ("Projekti TWiST: Drejt një modeli të ri të sipërmarrjes sociale në asetet e konfiskuara në Shqipëri." Marrë nga <https://www.partnersalbania.org/News/projekti-twist-drejt-nje-modeli-te-ri-te-sipermarrjes-sociale-ne-asetet-e-konfiskuara-ne-shqiperi/>;

Partners Albania. "Broshurë mbi projektin C.A.U.S.E - Përdorimi i pronave të konfiskuara për sipërmarrje sociale." Marrë nga <https://www.partnersalbania.org/publication/broshure-mbi-projektin-c-a-u-s-e-perdorimi-i-pronave-te-konfiskuara-per-sipermarrje-sociale/>.

### 3.3 Hapësirat për rrezik korrupsioni dhe përmirësimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit mbi rikuperimin e asetëve

Në kalendarin<sup>13</sup> e punimeve të Kuvendit, për periudhën 10 prill- 28 prill 2023, si dhe në faqen online ku janë të publikuara projektligjet në shqyrtim na rezultoi si një nga projektligjet, që synonte të rikuperonte dëmet (pasuri e luajtshme, vlerë monetare), që i janë shkaktuar Shtetit (subjekteve publike) nga punonjësit publikë, si të punësuar apo në marrëdhënie të tjera me subjektin publik (po përdorim terminologjinë e projektligjit të cituar), **inisiativa legjislative e deputetit B. L., projektligji<sup>14</sup> “Për përgjegjësinë financiare të punonjësve publikë”**. Edhe pse ky nuk është një projektligj, që ndryshon ligjin në fuqi nr. 34/ 2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, por meqenëse ky projektligj synon të rikuperojë në mënyrë të shpejtë, shpërblimin (pasuri e luajtshme- vlerë monetare) për dëme të pretenduara të punonjësve publikë dhe t'i rikthejë ato në buxhetin e Shtetit, po e marrim në shqyrtim si pjesë të korpusit legjislativ të rikuperimit të asetëve. Pra në rastin konkret kemi të bëjmë me një pjesë të pasurive<sup>15</sup> të trajtuara në ligjin nr. 34/ 2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar.

Në nenin 81, të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera se: “Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.” Nismat ligjore, që propozohen nga Këshilli i Ministrave ndjekin procedurat<sup>16</sup> ligjore, të prera të parashikuara në ligjin nr. 9000, datë 30. 1. 2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe në vendimin nr. 584, datë 28. 08. 2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, procedura të cilat garantojnë ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së projektaktit, çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislative, mendimet miratuese të ministrive dhe subjekteve të interesuara, transparencën paraprake me shpalljen online për konsultim publik, si dhe shqyrtimin paraprak të hapësirave eventuale për korrupsion, ndërkohë që për iniciativat ligjore, që vijnë nga deputetët apo 20 mijë zgjedhës nuk i kalojnë këto procedura administrative paraprake. Sugjerohet që Kuvendi të gjitha projektligjet e propozuara për shqyrtim t’ia nënshtrojë një kontrolli paraprak për hapësira eventuale për korrupsion, bazuar në rubrikat e renditura më poshtë, por edhe në të tjera, varësisht veçantisë së projektligjit në shqyrtim.

**A. Dykuptueshmëria** - Dykuptueshmëria si kriter i vlerësimit të hapësirave për korrupsion ka të bëjë atëherë, kur një normë juridike, fjali apo shprehje ka më shumë se një kuptim, duke krijuar

<sup>13</sup><http://www.parlament.al:5000/Files/202304181118191825Kalendari%20i%20punimeve%2010%20Prill%202023%20-%2028%20Prill%202023.docx%20i%20ndryshuar.pdf>

<sup>14</sup> <http://staging.parlament.al/ProjektLigje/IndexList>;

<sup>15</sup> Neni 2 “Përkufizime”, të ligjit nr. 34/ 2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:...ë) “Pasuritë e regjistruara” janë pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, të regjistruara në regjistra publik, pasuritë e luajtshme dhe shumat monetare, të regjistruara pranë institucioneve financiare ose subjekte të licencuara nga organet përkatëse shtetërore për ruajtjen e tyre, pasuritë dhe kuotat e aksionet e shoqërive tregtare, të regjistruara në regjistrin e shoqërive tregtare...”

<sup>16</sup> Shih edhe udhëzimin nr. 6, datë 29. 04. 2022, të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”;

kësisoj konfuzion te zbatuesi i së drejtës dhe duke lënë hapësira subjektive në zbatimin e vetë ligjit.

**A.1 Stili gjuhësor** – Gjuha e projektligjit duhet të jetë e thjeshtë, e thukët, me fjali të ndërtuara saktë nga pikpamja gramatikore dhe leksikore.

### **A.1.1 Fjalët e përzgjedhura a janë të sakta?**

Projektligji ka plot terma të rinj e të papërcaktuar mirë, si: subjekt publik, punonjës publik, përgjegjësi financiare, etj. Projektligji është i mbushur me neologjizma, që krijojnë kolizion me institutet juridike, të parashikuara, me ligje të posaçme, të miratuara me shumicë të cilësuar p.sh në nenin 5 “Përkufizime”, në pikën 1, të tij parashikohet se: “Subjekt publik” në kuptimin e këtij ligji përcaktohen: njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare, ku shteti zotëron mbi 50% të aksioneve.” Ky përcaktim “subjekt publik” është neologjizëm dhe krijon konfuzion me Kodin Civil, ku në nenin 24 të tij parashikohet se: “Personat juridike janë publikë dhe privatë”, e në nenin 25, të tij parashikohet se: “Persona juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik...” Në projektligj parashikohen disa lloje përgjegjësish: përgjegjësi e plotë, përgjegjësi e kufizuar, përgjegjësi e përbashkët, përgjegjësi financiare specifike, përgjegjësi financiare e rënduar, etj. Ndërkohë që në Kodin Civil janë të parashikuara në mënyrë shtrënguese përgjegjësitë, në rastin e shkakimit të dëmit, të tilla si: përgjegjësia e punëdhënësit, përgjegjësia e përfaqësuesit, përgjegjësia nga përdorimi i kafshëve, përgjegjësia nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme, përgjegjësia për mjedisin, përgjegjësia për dëmin jopasuror, përgjegjësia solidarë, etj. Pra në thelb projektligji nuk përdor institutet juridike tashmë të konsoliduara me legjislacionin në fuqi dhe që janë në unison me doktrinën e së drejtës.

### **A.1.2 A janë ndërtuar fjalitë dhe frazat saktë duke mos lënë hapësirë për dykuptimësi?**

Në projektligj ka formulime të paqarta dhe që hapësirë për dykuptimësi.

Neni i projektligjit	Në nenin 2 parashikohet se: “Ligji ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet që lindin midis subjekteve dhe punonjësve publikë dhe të vendosë procedura lidhur me dëmet e shkaktuara prej këtyre të fundit, në periudhën që ata janë ose kanë qenë të punësuar ose në çfarëdo marrëdhënie me subjektin publik.”
Problemi	Shprehja “në çfarëdo marrëdhënie me subjektin publik” lë hapësirë për dykuptimësi. Pra në çfarë lloj tjetër marrëdhënieje ka qenë punonjësi publik me subjektin? Kjo duhet saktësuar.
Zgjidhja	Shprehja “...në çfarëdo marrëdhënie me subjektin publik” duhet të hiqet.

Në projektligji, në nenin 35, fjalia e dytë parashikohet se: “Çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet”. Ky lloj parashikimi është i papranueshëm për teknikën legjislative se jo vetëm vë në rrezik qenien ose jo në fuqi të dispozitave të tjera, por lë vend për keqkuptime dhe keqzbatim, kështu sugjerohet të hiqet. Në projektligj duhet të parashikohen saktë vetëm dispozitat ligjore konkrete që shfuqizohen dhe jo të përdoret një shprehje e tillë e karakterit të përgjithshëm që krijon paqartësi.

**A.2 Harmonizimi:** Projektligji duhet të përmbajë norma juridike, që kanë unitet me njëra-tjetrën, rrjedhshmëri, lidhje llogjike dhe që nuk krijojnë kontradikta brenda projektligjit vetë apo që nuk krijojnë kontradikta, ose më tej të bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

### **A.2.1. A ka dispozita kontradiktore brenda ligjit? A ka dispozita kontradiktore me ligjet e tjera?**

Në përmbajtjen e projektligjit nuk ka dispozita kontradiktore me njëra-tjetrën, ato janë më shumë evazive dhe lënë hapësire për subjektivizëm, si p. sh në nenin 6, pika 11 ku parashikohet ndër të tjera se: “11. Raste të tjera dëmsh reale, me karakter të drejtpërdrejtë që nuk përfshihen në kategoritë e përcaktuara në nenin 7.” Në një kohë që dëmet, të cilat passjellin përgjegjësi duhet të jenë të parashikuara shprehimisht dhe jo të lihen me dispozita blanket (të bardha).

Projektligji më së shumti bie ndesh me një tërësi dispozitash ligjore, që parashikohen në Kodet dhe në ligjet e posaçme, të miratuara me shumicë të cilësuar, si:

- Me Kodin Civil (nenet 24, 25, 608 e vijues të Kodit Civil) në pjesën e dispozitave për subjektet e së drejtës dhe më pas për institutin juridik të shkaktimit të dëmit dhe përgjegjësive përkatëse.
- Me Kodin e Punës (neni 203 “Parashkrimi”);
- Me Kodin e Procedurës Penale (nenet 68, 387 dhe 388);
- Me ligjin nr. 154/ 2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” (neni 15) ku renditen kompetencat e KLSH-së, kurse ky projektligj i ri e ngarkon KLSH-në edhe me një rol të ri.

Fjala/ shprehja e re                      Në nenin 3, paragrafi i fundit parashikohet se: “Ky ligj zbatohet pavarësisht nga përgjegjësia disiplinore, administrative apo penale.”

Problemi                                      Në doktrinën<sup>17</sup> e së drejtës analizohen tri llojet e përgjegjësive: administrative, civile apo penale. Nuk ka një përgjegjësi tjetër jashtë këtyre.

Në Kodin Civil “Përgjegjësia e punëdhënësit” Neni 618 parashikohet se: “Punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij. Personi

<sup>17</sup> Për më tepër shih publikimin e OECD dhe SIGMA “Për përgjegjësinë dhe disiplinën e nëpunësve civilë”, te linku në vijim <https://www.sigmaweb.org/publications/37890790.pdf>.

juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre.”

Zgjidhja

Projektligji duhet rishikuar nga pikpamja e së drejtës se tendenca për të krijuar një “përgjegjësi” të re krijon përplasje me doktrinën.

Në doktrinë pranohen tre llojet e përgjegjësive për nëpunësit civilë dhe për punonjësit e tjerë, të punësuar në institucione shtetërore apo në persona juridikë publikë: përgjegjësia disiplinore (administrative), civile dhe penale. Përgjegjësia civile ndaj një nëpunësi civil apo punonjësi tjetër si më lart, vjen si pasojë e një përgjegjësie disiplinore apo penale ndaj tij e më pas mund të ketë një kërkim (padi) civile për dëmin e shkaktuar. Pra punonjësi duhet të ketë kryer një shkelje të ligjit, që passjell përgjegjësi disiplinore apo penale ndaj tij dhe do të dëmshpërblejë për dëmin e shkaktuar nga veprimi apo mosveprimi i tij i paligjshëm. Ja pse nuk mund të ketë një lloj tjetër “përgjegjësie financiare” si kjo e parashikuar në këtë projektligj.

#### **A.2.2 A është terminologjia e përdorur e saktë dhe konsistente?**

Terminologjia e përdorur është jashtë terminologjisë ligjore të konsoliduar me Kodet, që janë në fuqi. P.sh në nenin 8, të projektligjit përdoret termi “Përgjegjësia e përbashkët”, ndërkohë për atë koncept juridik në kreun II “Detyrimet solidarë”, (nenet 423- 435) të Kodit Civil jepet në mënyrë shterruese se kur jemi para një detyrimi solidar, pra nuk përdoret termi “I përbashkët”, por solidar.

#### **A.2.3 A janë referencat e sakta dhe të qarta brenda ligjit? A janë referencat e sakta dhe të qarta tek ligjet e tjera?**

Në brendi të projektligjit referencat janë të sakta për nenet përkatëse. Në lidhje me referencat në ligjet e tjera, projektligji abstragon nga parashikimet ligjore në fuqi, pasi është I mbushur me neologjizma dhe terma të rinj juridikë, që krijojnë kolizion me termat juridikë tradicionale.

#### **A.2.4 A i mbulon teksti i ligjit të gjitha çështjet? A ekziston ndonjë vakuum ligjor?**

Projektligji nuk i mbulon të gjitha çështjet. Natyrshëm shtrohet pyetja nëse pas një procedure gjyqësore rezulton se punonjësi kishte të drejtë, ai nuk i kishte shkaktuar asnjë dëm financiar shtetit, saga administrative dhe gjyqësore ndaj tij i ka sjellë atij vetë një dëm moral dhe material, a ka përgjegjësi dhe a do të zbatohet i njëjti mekanizëm “përgjegjësie financiare” të shpejtë kundër audituesit, që ka pretenduar një dëm të paqenë? Projektligji nuk i jep përgjigje kësaj çështjeje.

### **B. RREZIQET SUBSTANCIALE**

**B.1 Objektivat e ligjit** – Objektivat e projektligjit parashikohen në dispozitat e përgjithshme të tij, të titulluara, si: “objekti”, “qëllimi”, ndërkohë një përshkrim më i detajuar i objektivave jepet në relacionin shoqërues të projektligjit, i cili duhet të përshkruajë problemin, që synon të zgjidhë

projektligji i ri, një vlerësim të gjendjes faktike dhe të argumentojë, që pse një projektligj i ri është zgjidhja e duhur për atë çështje të krijuar.

### **B.1.1 A është kryer vlerësimi paraprak dhe a është i saktë? A janë përcaktuar objektivat e ligjit në përputhje me vlerësimin paraprak?**

Në relacionin shoqërues të projektligjit nuk ka asnjë vlerësim paraprak të gjendjes faktike, e cila synohet të ndryshohet me këtë projektligj. Pra thuhet se ka një hendek mes dëmeve të pretenduara dhe rikuperimit të tyre, por pa e shoqëruar me asnjë statistikë. Dëme të pretenduara nga cili autoritet shtetëror, a janë ndjekur procedurat ligjore përkatëse, cilat janë vendimet gjyqësore në përfundim të atyre gjykimeve. Pa një përshkrim të saktë të situatës faktike nuk mund të dilet as në konkluzione dhe as të ofrohet zgjidhja e duhur, për më tepër një projektligj si ky që ndryshon jo vetëm ligjet në fuqi, por edhe doktrinën e së drejtës, duke krijuar një përgjegjësi të re, jashtë përgjegjësisë disiplinore, administrative apo penale (neni 3, i projektligjit). Arsyetimi i dhënë tek relacioni shoqërues është i pamjaftueshëm, pasi në të thuhet se pengesë ndër të tjera është neni 117 i Kodit të Punës dhe vendim nr. 1354, datë 6. 10. 2005, i Gjykatës së Lartë që nuk e njeht përgjegjësinë materiale. Pyetjet që shtrohen janë: si mundemi me një ligj që miratohet me shumicë të thjeshtë të ndryshojmë dispozita ligjore, që janë pjesë e Kodeve, të cilat miratohen me shumicë të cilësuar? Si mundemi të ndryshojmë krejt doktrinën në lidhje me përgjegjësinë administrative, civile apo penale të punonjësve? Në këtë kuptim, relacioni nuk përmban arsyetimin e duhur ligjor dhe argumentet në lidhje me pyetjet që lindin mbi këtë projektligj.

### **B.1.2 Rregullat e hartuara të ligjit a janë koherente me objektivat e ligjit?**

Në projektligj synohet të parashikohen rregulla për të përmbushur objektivat e tij, por si më lart shpjeguar, për shkak të normave juridike kontradiktore apo me shprehje subjektive, çënohet edhe përmbushja e objektivave.

Në relacionin shoqërues thuhet se ky projektligj do të pakësojë ndjeshëm volumin e çështjeve gjyqësore, kur në fakt nga projektligji rezulton e kundërta punonjësit ndaj të cilëve do të merren vendime për t'i ngarkuar me "përgjegjësi financiare" kanë të drejtë të ankohen në Gjykatë, pra nga zbatimi i këtij ligji shihet shtimi i çështjeve gjyqësore.

## **B.2 Procedurat**

### **B.2.1 A është përcaktuar diskrecioni në masën e duhur, që të mos jetë i gjerë? A ka kritere që përcaktojnë diskrecionin? A ka diskrecion për të zbatuar përjashtimin nga rregulli?**

Në projektligj ka dispozita që parashikojnë një lloj diskrecioni për autoritetet e ngarkuara më zbatimin e ligjit, por të paktën janë parashikuar kriteret e zbatimit të këtyre rasteve.

### **B.2.2 A ka diskrecion rregullator?**

Në projektligj nuk rezulton të ketë diskrecion rregullator për autoritetet përgjegjëse.

### **B.2.3 A janë përcaktuar të gjitha hapat e procedurës gjer në vendimmarrje?**

Procedura është e parashikuar në nenet 18- 27 të projektligjit, por mungon afati ligjor brenda të cilit titullari i institucionit nga ardhja në dijeni e një raporti për dëm eventual fillon procedurën për

seancë dëgjimore. Mos parashikimi i një afati të tillë ligjor lë një hapësirë për rrezik korrupsioni, që ndaj dikujt fillohet procedura dhe ndaj dikujt jo.

#### **B.2.4 A është e qartë procedura e përcaktuar?**

Procedura e parashikuar në projektligj në parim duket e qartë. Por ka dhe parashikime, të cilat janë të palidhura me procedurën konkrete. P.sh në nenin 32 të projektligjit parashikohet se: “Të gjitha detyrimet debitore të pranuar nga punonjësit, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohen titull ekzekutiv dhe nëse nuk shlyhen vullnetarisht i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm.” Nga analiza e kësaj dispozite burojnë disa pyetje:

- Në ç'mënyrë i kanë pranuar detyrimet punonjësit, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji?
- Si mund t'i jepet ligjit fuqiprapavepruese në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës? (interpretimi a contrario)
- A zbatohet i njëjti mekanizëm për seancë dëgjimore për këta punonjës?

Ja pra kjo dispozitë, përveç faktit që bie ndesh me Kushtetutës se i jep ligjit fuqi prapavepruese nuk parashikon një procedurë të caktuar shqyrtimi.

#### **B.2.5 A është e thjeshtë procedura, pa pengesa të tejskajshme?**

Procedura duket komplekse dhe burokratike për shkak të pranisë së shumë palëve të interesuara, si dhe të mungesës së barazisë së armëve në proces, sepse në një anë parashikohet të jetë, psh. KLSH-ja bashkë me Avokaturën e Shtetit përballë një punonjësi të thjeshtë dhe gjykimi kryhet nga titullari i institucionit përkatës.

#### **B.2.6 A sigurohet akses i duhur në informacion gjatë procedurës?**

Në nenin 24 të projektligjit parashikohen të drejtat e punonjësit në procedurën e caktimit të përgjegjësisë financiare, ku përfshihet edhe e drejta për t'u informuar.

#### **B.2.7 A janë caktuar afate për hapat proceduralë? A janë të sakta dhe të përshtatshme afatet?**

Afatet e përcaktuara duken të arsyeshme.

#### **B.2.8 A garanton konkurrencën e lirë procedura, nëse vendos rregulla përzgjedhëse?**

Nuk konstatohet që projektligjit të ketë ndikim në çështjet e konkurrencës së lirë.

#### **B.2.9 A është e qartë procedura e vendimmarrjes? A janë kriteret e qarta për vendimmarrje?**

Projektligji synon të përcaktojë rastet e një përgjegjësie apo tjetër dhe kriteret mbi të cilat vendos autoriteti i ngarkuar me ligj, por sërish ka vend për subjektivizëm, sidomos në kriteret e përcaktuara në nenin 25, të projektligjit.

### **B.3 Organi zbatues**

#### **B.3.1 A është caktuar një organ kompetent për zbatimin e ligjit?**

Në projektligj janë caktuar në mënyrë të detajuar se cilat janë organet kompetente për ta zbatuar atë, varësisht subjektit që ka shkaktuar dëmin. (neni 20 i projektligjit)

#### **B.3.2 A janë caktuar qartë kompetencat e organit? A ka mbivendosje kompetencash?**

Kompetencat e organeve si më lart janë të mirëpërcaktuara.

**B.3.3 Nëse organi zbatues është deleguar të rregullohet me akt nënligjor, a është caktuar një afat për nxjerrjen e organit nënligjor? A ka rrezik për ngritjen e vonuar të organit?**

Nuk është parashikuar që organet zbatuese të rregullohen me akt nënligjor.

**B.3.4 A është parashikuar më shumë se një organ për zbatimin e ligjit? A janë koherente kompetencat e tyre? A është e qartë se cili është organi kryesor përgjegjës?**

Nuk është përcaktuar më shumë se një organ për zbatimin e ligjit.

**B.3.5 A respektojnë rregullat e hartuara standardet e parandalimit dhe të shmangies së konfliktit të interesave?**

Në projektligj nuk ka një parashikim për konfliktin e interesit për organet e ngarkuara me zbatimin e ligjit, por zbatohet vetiu, në çdo rast të ushtrimit të funksioneve publike, ligji i posaçëm nr .9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

**B.4 Mbikëqyrja**

**B.4.1 A parashikon ligji një mekanizëm mbikëqyrës?**

Në projektligj nuk parashikohet një mekanizëm i posaçëm mbikëqyrës, por ka një mundësi ligjore për secilin subjekt që të ushtrojë ankim në gjykatë, kur konstaton se ligji është shkelur apo nuk është zbatuar si duhet.

**B.4.2 A garanton ligji transparencë të zbatimit të tij?**

Projektligji nuk garanton transparencë në zbatimin e tij, pasi nuk ka të parashikuar ndonjë dispozitë në të, që të paktën një herë në vit institucionet e ngarkuara të publikojnë një raport të përmbledhur, me të dhëna personale të anonimizuara, për çështjet që kanë shqyrtuar, vendimmarrjet e tyre dhe të përditësohet me vendimet respektive të Gjykatave.

**B.5 Sanksionet**

**B.5.1 A përcakton ligji sanksione në rast të shkeljes së detyrimeve?**

Sanksione të mirëfillta projektligji nuk përmban, por dispozitat në lidhje me vlerësimin e dëmit në rastet e përgjegjësive “të reja” janë të pahasura më parë në legjislacion dhe janë mjaft subjektive.

**B.5.2 A janë sanksionet proporcionale?**

Duke mos patur sanksione “in se” nuk mund të konstatojmë proporcionalitet.

**B.6 Kontrolli gjyqësor**

**B.6.1 A parashikon ligji kontrollin gjyqësor të veprimtarisë administrative?**

Në projektligj parashikohet mundësia që subjektet t’i drejtohen Gjykatës administrative, në rastet kur nuk janë dakort me vendimin e autoritetit të ngarkuar me ligj, por afati për të ngritur padi është 30 ditë, pra më i shkurtër se afati ligjor 45 ditor, i parashikuar si i tillë nga ligji nr.

49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

#### **B.6.2 Rregullat për kontrollin gjyqësor a janë formuluar qartë?**

Nuk ka ndonjë parashikim të posaçëm për kontrollin gjyqësor, por ndjek rregullat e caktuara me ligje të tjera. I rëndësishëm është parashikimi, që ushtrimi i ankimit në gjykatë e pezullon vetiu ekzekutimin e vendimit të ankimuar.

### **IV. Roli mbikqyrës i kuvendit në çështjet e rikuperimit të aseteve**

#### **4.1 Roli mbikqyrës i kuvendit**

Në nenin 28 “Raportimi periodik në Këshillin e Ministrave” të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Agjencia, në muajin janar të çdo viti, i paraqet Këshillit të Ministrave dhe **komisionit përgjegjës për çështjet ligjore të Kuvendit**, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, raportin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara përgjatë vitit pararendës, sipas këtij ligji.” Pra, nga kjo dispozitë rrjedh që Kuvendi nëpërmjet komisionit të ligjeve është i informuar, çdo vit për punën e kësaj Agjencie në fushën e rikuperimit të aseteve. Kuvendi ka miratuar një mekanizëm me vendimin e tij nr. 49/ 2017 “Për monitorimin e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të atyre të krijuara me ligj të veçantë”, si dhe një manual në zbatim të këtij vendimi. Për institucione të vecanta të administratës qëndrore raportimi kryhet në komisionin parlamentar përkatës, në këtë rast komisioni i ligjeve dhe është ky komision që përgatit një raport, të shoqëruar me projekt rezolutën përkatëse, që kur është rasti ia përcjell seancës plenare për shqyrtim ose e publikon atë dhe vë në dijeni Kryetarin e Kuvendit. Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit përgatit projektraportin “Për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit”. Raporti shqyrtohet dhe miratohet nga Byroja e Kuvendit, i njoftohet seancës plenare dhe bëhet publik.

Kuvendi po ashtu informohet në mënyrë direkte edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm, apo nga raporti i drejtuesit të SPAK-ut, në lidhje me pasuritë e sekuestruara apo për të cilat është marrë vendim konfiskimi nga Gjykata. Një mënyrë tjetër e informimit të Kuvendit është interpelanca me ministrin e Financave apo me ministrin e Brendshëm.

#### **4.2 Roli i aktorëve të sistemit parlamentar në mbikëqyrjen efektive të fushës së rikuperimit të aseteve**

Brenda sistemit parlamentar, bazuar edhe në analizën ligjore si më lart rezultojnë disa subjekte të përfshira eventualisht në mbikëqyrjen efektive të fushës së rikuperimit të aseteve:

- *Komisioni i ligjeve*- para këtij komisioni bëhen raportimet vjetore të ministrit të Brendshëm në lidhje me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;

- *Secili deputet*- mund të kërkojë interpelancë apo informacion si te Kryeministri apo anëtarët e Këshillit të Ministrave për çështjet e rikuperimit të aseteve.
- *Komisionet hetimore*- Kuvendi mund të ngrejë vetë komisione hetimi për këtë çështje;

#### **4.3 Roli i aktorëve të sistemit jo-parlamentar në mbikëqyrjen efektive të rikuperimit të aseteve**

Për të përmirësuar rolin mbikëqyrës të Kuvendit në çështjen e rikuperimit të aseteve, një rol të rëndësishëm luajnë aktorët e tjerë të cilët janë të përfshirë në mënyrë indirekte, duke përfshirë këtu organizatat e shoqërisë civile dhe median.

**Shoqëria civile** ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e rolit mbikëqyrës të parlamentit në rikuperimin e aseteve. Nëse ka një pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile në procesin politik, ajo mund të ndihmojë në ndjekjen dhe mbikëqyrjen e veprimeve të parlamentarëve dhe të qeverisë në lidhje me rikuperimin e aseteve.

Në veçanti, shoqëria civile mund të ndihmojë në:

- Ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të opinionit publik në lidhje me nevojën e rikuperimit të aseteve.
- Monitorimin e veprimeve të qeverisë dhe Kuvendit në lidhje me rikuperimin e aseteve dhe publikimin e raporteve të tyre.
- Ndihmën në hartimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave të nevojshme për të siguruar rikuperimin e aseteve dhe për të luftuar korrupsionin.
- Propozimin e zgjidhjeve dhe alternativave në raste kur veprimet e qeverisë dhe Kuvendit nuk janë të mjaftueshme për të garantuar rikuperimin e aseteve.

Media ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit në rikuperimin e aseteve, duke bërë të mundur që informacioni i rëndësishëm të arrijë tek publiku dhe të ndikojë në opinionin publik.

Në veçanti, media mund të ndihmojë në:

- Investigimin dhe raportimin e veprimeve të qeverisë dhe Kuvendit në lidhje me rikuperimin e aseteve.
- Ndërgjegjësimin e opinionit publik për nevojën e rikuperimit të aseteve dhe për ndikimin e korrupsionit në ekonominë dhe shoqërinë.
- Ndihmën në ngritjen e vetëdijes dhe në ngritjen e pyetjeve në lidhje me rikuperimin e aseteve.
- Monitorimin e procesit të rikuperimit të aseteve dhe publikimin e raporteve të tyre.
- Ndihmën në ngritjen e dialogut dhe debatit publik në lidhje me rikuperimin e aseteve dhe masat që mund të ndërmarrin qeveria dhe Kuvendi për ta përmirësuar procesin.

- Për këtë arsye, media e pavarur dhe e lirë është shumë e rëndësishme në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e rikuperimit të aseteve dhe në mbështetjen e demokracisë në vend.

## V. Rekomandime

Nga analiza e detajuar e projektligjit si më lart, janë identifikuar gjetje specifike duke u shoqëruar me rekomandime konkrete qoftë nga ana përmbajtësore ashtu edhe nga ana procedurale. Përpos ndryshimeve të rekomanduara specifike, ky dokument pune vjen me disa rekomandime më të përgjithshme që lidhen të hartimit dhe zbatimit të projektligjeve të lidhura me rikuperimin e aseteve në Shqipëri.

- Të hartohet një vlerësim i plotë i gjendjes faktike të zbatimit të rekomandimeve që janë lënë vitet e fundit për dëmshpërblim financiar, për të nxjerrë konkluzione se cilat janë problemet. Ky vlerësim duhet të jetë i hollësishëm dhe të përfshijë vlerësimin e implementimit të rekomandimeve, vëzhgimin e rezultateve dhe identifikimin e problematikave specifike në zbatimin e tyre.
- Të rishihet nëse përfshirja e një seance dëgjimore të palëve në shqyrtimin e rekomandimeve të lëna nga auditet e brendshme dhe të jashtme do t'i zgjidhte problemet e konstatuara apo thjesht do t'i shtonte kostot për Shtetin. Në këtë proces, duhet të konsiderohen përfitimet dhe koston e mundshme të kësaj ndryshimi në mënyrë objektive dhe të vendoset nëse kjo praktikë do të kontribuojë në përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve.
- Nëse vlerësohet se shtimi i një kreu të posaçëm në ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", me procedurën e seancës dëgjimore, ky projektligj ndryshues të publikohet për konsultim publik, për t'i lënë mundësinë subjekteve të interesuara të japin mendim mbi të. Kjo do të ndihmonte në sigurimin e transparencës dhe përfshirjes së aktorëve të interesuar, duke u lejuar ata të japin kontributin e tyre dhe të ndikojnë në përmirësimin e projektligjit në fokus.
- Varianti përfundimtar i projektligjit, në çastin që u shpërndahet komisioneve parlamentare për mendim, t'i nënshtrohet një analize të hapësirave për rrezik korrupsioni, të hartuar nga një ekspert i pavarur, i fushës. Kjo analizë do të identifikonte potencialet e rrezikut të korrupsionit që mund të lidhen me ndryshimet e propozuara në ligj dhe do të ofronte rekomandime për adresimin e tyre. Kjo do të siguronte një vlerësim objektiv dhe të pavarur të mundësive të korrupsionit dhe ndihmonte në ndërmarrjen e masave parandaluese për të minimizuar rrezikun.

Ky dokument pune ofron një serë rekomandimesh me natyrë të përgjithshme të cilat ndihmojnë në përmirësimin e rolit mbikqyrës të Kuvendit në ccështjet e rikuperimit të asetëve.

1. Kuvendi të publikojë në platformën ndërinstitucionale online rezolutën me rekomandime edhe për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;
2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të përditësojë faqen e saj online, si dhe ta pasurojë informacionin e ofruar për publikun, psh: te lista e pasurive që ofron me qira të jepen të dhënat e procesit, kur është hapur thirrja, lidhur kontrata, subjekti qiramarrës, etj.
3. Të rikonceptohet kompetenca e zhvillimit të ankandëve nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, pasi për pasuritë që rrjedhin nga veprimtaritë kriminale nuk ofrohet informacioni i duhur për zhvillimin e këtyre ankandëve apo të dhëna për blerësit e rinj të këtyre pasurive;
4. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të japë informacione në faqen e saj online për pasuri të cilat janë përdorur për të kompensuar viktimat e krimeve, si zbatim i detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore për paditë civile në procesin penal dhe të tjera të lidhura me to.

## Referencat

1. *Republika e Shqipërisë, Kuvendi*.  
<http://www.parlament.al/?asperrorpath=/ProjektLigje/IndexList;>
2. Ligji Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nr. 8417 (1998)  
<https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>
3. Republika e Shqipërisë, Kuvendi. (2004). *Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë*.  
<http://staging.parlament.al>. <http://staging.parlament.al/Files/sKuvendi/rregullorja.pdf>
4. Republika e Shqipërisë Kuvendi. (2004). *Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, neni 102*.  
<http://staging.parlament.al>. <http://staging.parlament.al/Files/sKuvendi/rregullorja.pdf>
5. Republika e Shqipërisë Kuvendi. (2004). *Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, neni 100*.  
<http://staging.parlament.al>. <http://staging.parlament.al/Files/sKuvendi/rregullorja.pdf>
6. Global Initiative. (2021). Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore. Në <https://globalinitiative.net/>. <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/11/Western-Balkan-RB10-SQ.pdf>
7. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal. (2022). Western Balkans Digital Economy Society Index. <https://www.rcc.int/home>. [https://www.rcc.int/docs\\_archive](https://www.rcc.int/docs_archive)
8. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nr 7895 (1995)
  1. [https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/11/Ligj\\_nr\\_7895\\_Kodi\\_penal\\_i\\_ndryshuar\\_2020.pdf](https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/11/Ligj_nr_7895_Kodi_penal_i_ndryshuar_2020.pdf)
9. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nr 7905 (1995)  
[https://ndihmajuridike.gov.al/transparenca/Legjislacioni%20Kombetar/Kodi\\_i\\_procedures\\_Penale\\_2019.pdf](https://ndihmajuridike.gov.al/transparenca/Legjislacioni%20Kombetar/Kodi_i_procedures_Penale_2019.pdf)
10. Reporter.al. (2021, October 1). Saga gjyqësore e kompleksit “Golden” mbyllet me pushim. <https://www.reporter.al/>. <https://www.reporter.al/2021/10/01/saga-gjyqesore-e-kompleksit-golden-mbyllet-me-pushim/>
11. Reporter.al. (2022, July 28). Sekuestrohen pronat e biznesmenit të dënuar për trafik droge, Anton Gjina. <https://www.reporter.al/>.  
<https://www.reporter.al/2022/07/28/sekuestrohen-pronat-e-biznesmenit-te-denuar-per-trafik-droge-anton-gjinaj/>
12. Reporter.al. (2021a). Databaza e Aseteve Kriminale. <https://www.reporter.al/>
13. Partnerët për ndryshim dhe Zhvillim. (2023). PROJEKTI TWIST: DREJT NJË MODELI TË RI TË SIPËRMARRJES SOCIALE NË ASETET E KONFISKUARA NË SHQIPËRI. <http://www.partnersalbania.org/sq/>. Partnerët për ndryshim dhe Zhvillim. Në <https://www.partnersalbania.org/News/projekti-twist-drejt-nje-modeli-te-ri-te-sipermarrjes-sociale-ne-asetet-e-konfiskuara-ne-shqiperi/>
14. Partnerët për ndryshim dhe Zhvillim. (2020). C.A.U.S.E. – PËRDORIMI I PRONAVE TË KONFISKUARA PËR SIPËRMARRJE SOCIALE. Në <http://www.partnersalbania.org/sq/>  
Partnerët për ndryshim dhe Zhvillim.  
<https://www.partnersalbania.org/publication/broshure-mbi-projektin-c-a-u-s-e-perdorimi-i-pronave-te-konfiskuara-per-sipermarrje-sociale/>

15. REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI. (n.d.-a). KALENDARI I PUNIMEVE TË KUVENDIT. Në <https://www.parlament.al/>.  
<http://www.parlament.al:5000/Files/202304181118191825Kalendari%20i%20punimeve%2010%20Prill%202023%20-%2028%20Prill%202023.docx%20i%20ndryshuar.pdf>
16. REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI. (n.d.-c). REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI. <http://www.parlament.al/?aspxerrorpath=/ProjektLigje/IndexList>;
17. Ligji “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara ndryshuar me ligjin nr.19/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.34/2019, Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, nr. 34 (2019) [https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Ligj\\_34-2019.pdf](https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Ligj_34-2019.pdf)
18. Udhëzim i ministrit të Drejtësisë: “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, nr.6 (2022) [https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/Xerox-Scan\\_02062022000129.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/Xerox-Scan_02062022000129.pdf)
19. SIGMA. (2003). LIABILITIES AND DISCIPLINE OF CIVIL SERVANTS. Në [www.sigma-global.com](http://www.sigma-global.com)  
<https://www.sigmaweb.org/publications/37890790.pdf>
20. PLATFORMA NDËRINSTITUCIONALE. (n.d.). PLATFORMA NDËRINSTITUCIONALE.  
<http://134.0.63.165:5000/public>

## **Aneks 1: Lista e pyetjeve në fushën e prokurimeve publike**

### **A/ DEPUTETËT NË KUVEND**

- 1) Gjatë ushtrimit të detyrës tuaj cfarë keni evidentuar si më shqetësuese në fushën e rikuperimit të aseteve të krijuara nga veprimtaritë kriminale? (eventualisht- A keni dhënë sugjerime në lidhje mesa sipër?)
- 2) A keni ushtruar të drejtën tuaj për interpelancë, pyetje, informacione, pjesëmarrje në komisione hetimore për çështje që kanë lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, etj? Nëse po, konkretisht cfarë rezultati keni arritur? Nëse jo, a jeni hasur me ndonjë faktor pengues?
- 3) Në planin e përgjithshëm cfarë do të sugjeronit për të përmirësuar rolin ligjberës dhe mbikqyrës të Kuvendit në fushën e rikuperimit të aseteve?

### **B/ AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA**

- 1) Cilat janë problemet që evidentoni më shumë që ushtrimit të detyrës tuaj me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara?
- 2) A keni një database publik ku evidentoni cdo veprim të kryer në administrimin e këtyre pasurive?
- 3) A shkon një pjesë e këtyrë pasurive për të dëmshpërblyer viktimat e veprave kriminale? Cili është mekanizmi që përdorni?
- 4) Në c'mënyrë arrini ta evitoni dhënien në përdorim apo shitjen e këtyre pasurive sërish në të njëjtat duar përsonash që e kanë krijuar me veprimtari kriminale?
- 5) Cfarë do të sugjeronit për përmirësim në këtë fushë?

### **C/ MINISTRIA E FINANCAVE**

- 1) Një pjesë e pasurive të konfiskuara nga veprimtaritë kriminale i kalon ministrisë Tuaj për të zhvilluar procedurat e ankandit. Cilat janë problemet kryesore që evidentoni në ankandet e këtyre pasurive?
- 2) Si arrini t'i shmangni personat e përfshirë në veprimtari kriminale (ata që i kishin në pronësi apo përdorim) që të mos i rimarrin këto pasuri?
- 3) A i evidentoni në një database publik online të gjitha të dhënat përsa sipër?
- 4) Cfarë mund të sugjeroni për përmirësim në këtë fushë?

### **Ç/ KLSH/ AVOKATI I POPULLIT**

- 1) Gjatë ushtrimit të detyrës tuaj a keni patur çështje që kanë lidhje me rikuperimin e aseteve të krijuara nga veprimtaritë kriminale?
- 2) Cilat janë problemet bazë që keni evidentuar?
- 3) Cfarë duhet përmirësuar?

#### **D/ PËRFAQËSUES NGA BIZNESI/ CSOS**

- 1) Subjekti juaj a merr pjesë në procedurat e ankandit për të blerë pasuri që janë të konfiskuara nga Shteti?
- 2) A jeni shpallur fitues në ndonjë prej procedurave? Nëse po, çfarë keni konstatuar pasi jeni bërë pronar i asaj pasurie?
- 3) Cilat janë problemet që iu shqetësojnë në lidhje me procedurat e ankandit të pasurive të konfiskuara?
- 4) Cfarë duhet përmirësuar?

#### **DH/ PËRFAQËSUES NGA MEDIA**

- 1) A keni përgatitur ndonjë shkrim apo kryer ndonjë investigim në lidhje me çështjet e rikuperimit të aseteve kriminale?
- 2) Cfarë do të sugjeronit ju për t'u përmirësuar në procedurat e rikuperimit të aseteve kriminale dhe të ankandive që zhvillohen për ta?

## **Aneks 2: Listë e konsultimeve në proces mbi aspekte specifike të rikuperimit të aseteve kriminale në Shqipëri**

- Institucioni: Kuvendi i Shqipërisë  
z. Etjen Xhafaj, Deputet, Grupi parlamentar PS  
z. Helidon Bushati, Deputet, Grupi parlamentar PD
- Institucioni: Kontrolli i Lartë i Shtetit  
Personi:
- Institucioni: Avokati i Popullit  
Personi:
- Institucioni: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara  
Personi:
- Institucioni: Reporter.al, publikim i BIRN  
Personi: z. Gjergj Erebara
- Institucioni: Shoqata e Eksportuesve të Shqipërisë  
Personi: z. Alban Zusi
- Institucioni: Shoqata e Prodhuesve të Shqipërisë  
Personi: z. Arben Shkodra
- Institucioni: Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim  
Personi: z. Ardian Haçkaj
- Institucioni: Partners Albania  
Personi: z. Klotilda Kosta

### Aneks 3: Lista e akteve ligjore

1. Ligji nr. 8417, datë 21. 10. 1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
2. Ligji nr. 8635 datë 06. 07. 2000 “Për ratifikimin e Konventës Civile për korrupsionin”
3. Ligji nr. 8778, datë 26. 04. 2001 “Për ratifikimin e Konventës Penale për korrupsionin”
4. Ligji nr. 9492, datë 13. 3. 2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit”
5. Ligji nr. 45/ 2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare””
6. Ligji nr. 7905, datë 21. 3. 1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
7. Ligji nr. 7895, datë 27. 1. 1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
8. Rregullorja<sup>18</sup> e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
9. Ligji nr. 8891, datë 2. 5. 2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”
10. Ligji nr. 10 192, datë 3. 12. 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar
11. Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar
12. Ligji nr. 33/ 2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”

---

<sup>18</sup> Rregullorja e Kuvendit miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005, vendimin nr. 193, datë 7.7.2008, vendimin nr. 21, datë 04.03.2010, vendimin nr. 41, datë 24.6.2010, vendimin nr. 88, datë 24.2.2011, vendimin nr. 41 datë 30.05.2013, vendimin nr. 95 datë 27.11.2014, vendimin nr. 88 datë 14.9.2017 dhe vendimin nr. 85 datë 18.7.2019;